

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PËR EKSPERTË JO-KYÇ

Projekti i financuar nga BE-ja “Asistencë Teknike për përmirësimin e mjedisit mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut”
Numri i identifikimit: EuropeAid/140131/DH/SER/MK

Projekti i financuar nga BE-ja “Asistencë teknike për përmirësimin e mjedisit mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut” kërkon ekspertë me përvojë për detyra specifike që e mbështesin zbatimin e projektit. Projekti synon të mbështesë Qeverinë në përmirësimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, dhe në të njëjtën kohë të ofrojë mbështetje për organizatat e vogla dhe bazë në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive të tyre operacionale të qëndrueshme.

Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Corporate & Public Management Consulting International (CPM) përmes dy komponentëve: Komponenti 1) Mbështetja e zbatimit të objektivave kryesore nga Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile – Prioriteti I, dhe Komponenti 2) fokusim në zbatimin e mbështetjes së drejtpërdrejt në natyrë përmes Mekanizmit të Qëndrueshmërisë Civile (CRM) të përshtatur për nevojat e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Programi CRM ofron mbështetje të drejtpërdrejtë fleksibile, transparente dhe të qasshme në punën e bazuar në të drejtat dhe përfitimet publike të realizuara nga organizatat e shoqërisë civile.

PROFILET E EKSPERTËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES

EKSPERTË TË LARTË JO-KYÇ – EKSPERTË/TRAJNERË PËR NDËRTIM TË KAPACITETEVE (RI-NJOFTIM)

Inputet (kontributet): trajnime me deri në 10 ditë pune secili nga shkurti – mars 2024 (disa pozita)

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, shkenca politike, shkenca sociale, ekonomi ose çdo fushë që ka lidhje me detyrën;
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office);
- Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze të shkruar dhe të folur, njohja e gjuhës/gjuhëve lokale është një avantazh;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe ndërpersonale;
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike.

Përvoja e përgjithshme profesionale

- Së paku shtatë (7) vite përvojë pune në fusha të tilla si shoqëria civile dhe/ose të drejtat e njeriut, dhe/ose demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit.

Përvojë specifike profesionale

- Së paku pesë (5) vite përvojë profesionale në fushat relevante për temën(at) e trajnimit;
- Së paku tre (3) vite përvojë në ofrimin e trajnimeve për tema specifike;
- Eksperiencë e demonstruar në punën me shoqërinë civile..

Përgjegjësitë: Të ofrojë mbështetje për ekipin e projektit AT, në zbatimin e programit të ngritjes së kapaciteteve që përbëhet nga tema të ndryshme trajnime specifike:

1. Avokimi dhe mirëkuptimi për anëtarësimin në BE;
2. Përdorimi i qasjes së bazuar në të drejtat në hartimin e veprimit;
3. Avokimi në nivel lokal, pjesëmarrja e OSHC-ve në hartimin e politikave dhe monitorimi i zbatimit të politikave;
4. Rrjetëzimi sektorial dhe ndërtimi i partneritetit;
5. Vizibiliteti dhe komunikimi i punës së OSHC-ve; Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve dhe komunitetit të biznesit;
6. Aspektet organizative dhe menaxhuese të punës së OSHC-ve;
7. Praktikën e financave dhe kontabilitetit lidhur me OSHC-të;
8. Tema të tjera që lidhen me mjedisin mundësues të OSHC-ve.

APLIKIMI

Kandidatët e interesuar që plotësojnë kriteret e mësipërme, duhet të dorëzojnë një CV të formatit të BE-së në gjuhën angleze në adresat recruitment@cpmconsulting.eu dhe stefanovic@cpmconsulting.eu, deri më **16 shkurt 2024 në orën 16:00 CET, duke cekur temën(t) specifike të trajnimit në subjekt.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen me e-mail. Aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

